



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Kuvendi**

**PROJEKT LIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**PËR**

**SISTEMIN E VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË SË GJYQTARËVE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**V E N D O S I:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Objekti**

Objekti i këtij ligji është të përcaktojë parimet, kriteret dhe procedurat për vlerësimin profesional dhe etik të veprimtarisë së gjyqtarëve dhe të kryetarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

Neni 2

**Qëllimi**

1. Qëllimi i vlerësimit është:

- a) të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë profesionale dhe etike të gjyqtarëve;
- b) të përcaktojë standarde të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve;
- c) të informojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë në procesin e vendimmarrjes në lidhje me ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve në funksion të zhvillimit të karrierës bazuar mbi meritat;
- ç) të informojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës në lidhje me nevojat për trajnim të gjyqtarëve dhe për të lehtësuar planifikimin e trajnimit të tyre;
- d) të identifikojë gjyqtarët që mund të kenë aftësi të veçanta profesionale për sistemin e drejtësisë;

dh) të kontribuojë në përmirësimin e strukturës organizative të gjykatave, të kushteve të punës të gjyqtarëve dhe të sistemit gjyqësor.

### Neni 3

#### **Përkufizime**

Për efekte të zbatimit të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) Afatet e caktuara në këtë ligj janë kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilët llogariten me ditë pune.
- b) “Çështje gjyqësore pa palë kundërshtare” është çdo çështje gjyqësore e regjistruar në gjykatë, e paraqitur në formën e kërkesës, me të cilën nuk kërkohet zgjidhja në themel e një mosmarrëveshjeje. Këto çështje përfshijnë çështjet civile pa palë kundërshtare, çështjet administrativo-penale dhe masat e sigurimit, si dhe çështjet administrative pa palë kundërshtare.
- c) “Gjyqtar” është gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë apo i gjykatës së apelit. Rregullat e vendosura për gjyqtarin përfshijnë edhe kryetarin e gjykatës, përveçse kur ky ligj parashikon ndryshe.
- ç) “Gjyqtar kryesues” është gjyqtari, të cilit i caktohet me short gjykimi i çështjes gjyqësore, në cilësinë e kryesuesit apo të relatorit të trupit gjykues.
- d) “Periudha e vlerësimit” është periudha e punës së gjyqtarit, përgjatë të cilës maten treguesit e tij profesionalë dhe etikë.
- dh) “Rendimenti i përfundimit të çështjeve” të gjyqtarit është raporti i numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga një gjyqtar në raport me numrin e çështjeve gjyqësore të ngarkuara atij brenda një viti kalendarik.
- e) “Sistem vlerësimi”, i referohet tërësisë së rregullave të vlerësimit profesional dhe etik të miratuar me këtë ligj dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.
- ë) “Standard minimal kohor” është koha orientuese e caktuar brenda të cilës duhet të përfundojë një çështje gjyqësore. Këshilli i Lartë i Drejtësisë miraton dhe përditëson standardet minimale kohore, duke marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë natyrën e çështjes gjyqësore, kompleksitetin e saj, sasinë e çështjeve gjyqësore të regjistruara në gjykatë, numrin e personelit dhe infrastrukturën e gjykatës.
- f) “Vendim procedural” është vendimi që nuk zgjidh mosmarrëveshjet për themelin, si vendimi për refuzimin e një kërkesë ose vendimi për përfundimin e procedurës.
- g) “Koha mesatare e arsytimit të vendimit” është treguesi mesatar kohor i arsytimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari në periudhën e vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit të vendimit në sekretari.
- gj) “Vlerësues” është personi i përfshirë në procesin e përgatitjes dhe të vendimmarrjes mbi vlerësimin profesional dhe etik të veprimtarisë së gjyqtarëve.

### Neni 4

#### **Parimet**

Sistemi i vlerësimit bazohet dhe zbaton parimet e mëposhtme:

- a) parimi i pavarësisë, sipas të cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e gjyqtarit.
- b) parimi i meritokracisë dhe i zhvillimit të karrierës, sipas të cilit vlerësimi kryhet, duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale.
- c) parimi i efikasitetit, sipas të cilit vlerësimi kryhet nëpërmjet një procesi të shpejtë, me anë të procedurave të thjeshta dhe në afate kohore të arsyeshme për të siguruar të dhëna në kohën e duhur për karrierën e gjyqtarit.
- ç) parimi i procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit procedura e vlerësimit respekton standardet e procesit të rregullt ligjor për gjyqtarin, duke përfshirë të drejtën për t'u njohur me aktet, të drejtën e aksesit në dosjen e vlerësimit, të drejtën për të marrë pjesë në proces, të drejtën e kontradiktoritetit, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për t'u mbrojtur, të drejtën për të patur një akt vlerësimi të arsyetuar dhe të drejtën për t'u ankuar mbi aktin e vlerësimit.
- d) parimi i konfidencialitetit, sipas të cilit subjektet e ngarkuara me detyrën e vlerësimit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të gjyqtarit që vlerësohet, si dhe të dhënat e tij personale sipas legjislacionit në fuqi. Këto subjekte përjashtohen nga ky detyrim vetëm kur informacioni i jepet gjyqtarit që vlerësohet apo organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës zyrtare.

#### Neni 5

### **Papajtueshmëritë dhe konflikti i interesave**

Në procesin e vlerësimit zbatohen rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për papajtueshmërinë e ushtrimit të detyrës dhe për parandalimin e konfliktit të interesave.

#### Neni 6

### **Subjektet e ligjit dhe vlerësimi i i gjyqtarëve të rekrutuar në strukturat e tjera**

1. Vlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, duke përfshirë dhe kryetarët e gjykatës.
2. Kryetarët e gjykatave vlerësohen gjithashtu edhe për veprimtarinë e tyre si kryetar gjykate.
3. Gjyqtarët, të cilët janë rekrutuar inspektorë në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vlerësohen sipas rregullave të zbatueshme për vlerësimin e veprimtarisë së tyre.
4. Gjyqtarët, të cilët janë rekrutuar në struktura të tjera juridiko-profesionale dhe ruajnë statusin e gjyqtarit, vlerësohen sipas rregullave të vlerësimit në strukturën ku ata janë rekrutuar.
5. Rezultatet e vlerësimit të veprimtarisë së ushtruar prej gjyqtarëve të rekrutuar sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, merren parasysh në rastet e ngritjes në detyrë të tyre. Në çdo rast, rekrutimi i gjyqtarit sipas pikës 3 dhe 4 të këtij neni, përbën një tregues pozitiv në vlerësimin e kriterit të aftësive njerëzore dhe angazhimit profesional, pavarësisht kohës së rekrutimit.

**KREU II**  
**KRITERET, BURIMET DHE NIVELET E VLERËSIMIT**

**Seksioni I**  
**Vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit**

Neni 7

**Kriteret e vlerësimit**

1. Vlerësimi kryhet sipas kritereve më poshtë:
  - a) Aftësitë gjyqësore;
  - b) Aftësitë organizative;
  - c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit; dhe
  - ç) Aftësitë njerëzore dhe angazhimi profesional.

Neni 8

**Aftësitë gjyqësore**

1. Me këtë kriter vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe në drejtim të arsytimit ligjor.
2. Aspekti i njohurive ligjore matet nga vlerësimi i vendimeve të gjyqtarit duke përdorur si tregues aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën.
3. Aspekti i arsytimit ligjor matet nga tregues të tillë si qartësia dhe gjithëpërfshirja e vendimit, nga struktura koherente dhe e mirëorganizuar e vendimit, si dhe nga cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.
4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin apo logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Neni 9

**Aftësitë organizative**

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën e punës, për të kryer procedurat gjyqësore dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore. Aftësitë organizative vlerësohen duke marrë në konsideratë të gjitha çështjet dhe duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga gjyqtari dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.

- a) Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet nga treguesit për të respektuar afatet ligjore, për të plotësuar standardet minimale kohore, rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit.
- b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore matet me treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për organizimin e

procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproductive, duke përfshirë edhe monitorimin e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore matet me treguesit për rregullsinë e akteve në dosjen gjyqësore dhe krijimin pa mungesa të tyre.

#### Neni 10

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit**

1. Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për etikën në punë, integritetin dhe paanësinë.
2. Etika në punë e gjyqtarit në lidhje me përkushtimin dhe përgjegjshmërinë në detyrë, matet nga treguesit e nxjerrë nga burimet e vlerësimit si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarit të gjykatës dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit.
3. Integriteti i gjyqtarit në lidhje me qëndrimin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, matet nga treguesit e nxjerrë nga burimet e vlerësimit si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarit të gjykatës, dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit.
4. Paanësia e gjyqtarit lidhet me kujdesin e gjyqtarit ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave. Kjo aftësi matet nga treguesit mbi përdorimin e fjalorit diskriminues, mbi numrin tejet të lartë të rasteve të pranuar të kërkesave të palëve për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi, si dhe nga tregues të tjerë të nxjerrë nga burime të tjera të vlerësimit.

#### Neni 11

### **Aftësitë njerëzore dhe angazhimi profesional**

1. Me këtë kriter vlerësohet aftësia e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gadishmëria për t'u angazhuar në aktivitete të tjera.
2. Aftësia e komunikimit të gjyqtarit matet me tregues mbi komunikimin e qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun dhe të tretët duke respektuar konfidencialitetin dhe parimet e mbrojtjes të të dhënave personale.
3. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët matet me tregues mbi komunikimin dhe bashkëveprimin me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe mbi shkëmbimin e njohurive apo të përvojës profesionale me ta.
4. Gadishmëria për t'u angazhuar në aktivitete të tjera matet me tregues si pjesëmarrja e gjyqtarit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të mbikëqyrur magjistratët gjatë stazhit të tyre profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve të rinj, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitete ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit gjyqësor dhe publikimet ligjore akademike. Pjesëmarrja e gjyqtarit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet bazuar në informacionin e dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, duke iu referuar vlerësimit "Shumë Mirë" në rastet e përmbushjes së detyrimit ligjor për të marrë pjesë në jo më shumë se 20 ditë në vit

dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë 5 vjetëve. Nivelet e tjera të vlerësimit përcaktohen me rend zbritës të këtij standardi.

## Neni 12

### **Burimet e vlerësimit**

Vlerësimi bazohet në burimet e mëposhtme:

- a) dosjen personale të gjyqtarit;
- b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimit nga nenet 9 deri në 11 të këtij ligji;
- c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe zvarritje, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive. Dosjet duhet të sigurojnë një përfaqësim të plotë të llojit të çështjeve të gjykuara dhe në çdo rast, numri i dosjeve të përzgjedhura nuk duhet të jetë më i lartë se 22;
- ç) vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe vendimet e paraqitura prej tij. Në çdo rast, numri i vendimeve të paraqitura nuk duhet të jetë më i lartë se 4 në vit;
- d) mendimi i kryetarit të gjykatës;
- dh) të dhënat mbi verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit;
- e) informacion me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës apo institucione të tjera që tregon pjesëmarrjen dhe aktivizimin e gjyqtarit në aktivitete trajnuese;
- ë) vendimin disiplinor përfundimtar ndaj gjyqtarit të dhënë gjatë periudhës së vlerësimit;
- f) kundërshtimet e gjyqtarit dhe procesverbalet eventuale të seancave dëgjimore të tij gjatë procesit të vlerësimit;
- g) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit.

## Neni 13

### **Nivelet e vlerësimit**

1. Vlerësimi përbëhet nga pesë nivelet e mëposhtme:

- a) “Shkëlqyeshëm”: në rastin e veprimtarisë etike dhe profesionale me cilësi jashtëzakonisht të lartë ;
- b) “Shumë mirë”: në rastin e veprimtarisë etike dhe profesionale me cilësi mbi mesataren.
- c) “Mirë”: në rastin e veprimtarisë etike dhe profesionale me cilësi mesatare;
- ç) “Mjaftueshëm” në rastin e veprimtarisë etike dhe profesionale me cilësi nën mesataren.
- d) “I pamjaftueshëm”: në rastin e veprimtarisë etike dhe profesionale me cilësi të dobët.

2. Vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur veprimtaria e gjyqtarit është vlerësuar “shkëlqyeshëm” për të katër kriteret.

3. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur gjyqtari vlerësohet “Shumë mirë” për tre kritere dhe “Mirë” për atë që mbetet dhe në çdo rast, nëse kryetari i gjykatës nuk e ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar “I pamjaftueshëm” . Në çdo rast, kriteri “aftësitë gjyqësore” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të jenë vlerësuar “Shumë mirë”.

4. Kur aftësitë e gjyqtarit vlerësohen “Mirë” për dy kriteret dhe “Mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera, vlerësimi i përgjithshëm jepet “Mirë”. I njëjti rregull zbatohet edhe për barazimin e vlerësimit të kriterëve midis niveleve “Mjaftueshëm” dhe “I pamjaftueshëm” me përjashtim kur parashikohet ndryshe në pikën 3 të këtij neni. Në çdo rast, kriteri “aftësi gjyqësore” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të vlerësohen “Shumë mirë”.

5. Vlerësimi i përgjithshëm “I pamjaftueshëm” jepet në rastet e mëposhtme:

- a) kur gjyqtari vlerësohet “I pamjaftueshëm” për të paktën 3 kriteret; ose
  - b) kur gjyqtari vlerësohet “I pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë gjyqësore” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” dhe jo më shumë se “Mirë” për dy kriteret e tjera;
- Në çdo rast vlerësimi “I pamjaftueshëm” nuk do të jepet nëse kryetari i gjykatës e ka vlerësuar gjyqtarin me “Shumë mirë”.

## **Seksioni II**

### **Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të gjykatës**

#### Neni 14

#### **Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit**

1. Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të gjykatës kryhet sipas kriterëve më poshtë:

- a) Aftësitë drejtuese dhe organizuese; dhe
- b) Aftësitë komunikuese.

#### Neni 15

#### **Aftësitë drejtuese dhe organizuese**

1. Me këtë kriter vlerësohet aftësia e kryetarit lidhur me organizimin e qartë të veprimtarisë administrative dhe gjyqësore nëpërmjet vendimeve dhe urdhrave për të respektuar afatet dhe për të shfrytëzuar sa më mirë burimet që ka në dispozicion, si dhe për të siguruar aksesin dhe transparencën në gjykatë.

2. Kjo aftësi matet me tregues mbi:

- a) mirëorganizimin e gjykatës në dhoma apo seksione;
- b) ndarjen e trupave gjykues;
- c) planifikimin e gjyqtarëve për çështjet të natyrës urgjente;
- ç) ndarjen e çështjeve me short;
- d) zëvendësimin në kohë të gjyqtarëve që kanë pengesa në gjykim;
- dh) zhvillimin e mbledhjeve tematike;
- e) planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike sipas nevojave të gjykatës;
- ë) mbikëqyrjes me qëllim përmirësimin e informacionit në faqen zyrtare të internetit të gjykatës;
- f) mbikëqyrjes për krijimin e ambienteve të përshtatshme në gjykatë me nevojat e palëve dhe të publikut, duke përfshirë edhe shenjat orientuese në gjykatë.
- g) organizimin e trajnimeve për gjyqtarët apo për punonjësit e gjykatës.

3. Angazhimi i kryetarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit gjyqësor apo në trajnime profesionale mbi drejtimin dhe organizimin e gjykatës përbën përparësi në matjen e kësaj aftësie.

#### Neni 16

#### **Aftësitë komunikuese**

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e kryetarit për të vendosur një linjë komunikimi të qartë, në kohë dhe transparente. Kjo aftësi matet me treguesit mbi:

- a) bashkëpunimin efektiv dhe në kohën e duhur me inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor ose Kontrollit të Lartë të Shtetit; dhe
- b) komunikimin me publikun dhe të tretët, të evidentuar në përcaktimin e orareve të pritjes me publikun, dokumentacionin e takimeve ose të përgjigjeve drejtuar institucioneve të ndryshme.

#### Neni 17

#### **Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e kryetarit të gjykatës**

Vlerësimi për kryetarin e gjykatës bazohet në burimet e mëposhtme të vlerësimit:

- a) dosjen personale të tij;
- b) vetëvlerësimi i kryetarit të gjykatës, i cili përmbush për aq sa është e mundur kriteret e vetëvlerësimit të gjyqtarit;
- c) raportet vjetore të kryetarit, që përfshin rezultatet financiare dhe menaxhimin e gjykatës si dhe procesverbalet e analizave vjetore të mbledhjeve të gjykatës dhe raportin e të deleguarit pjesëmarrës të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe regjistrimet me mjete digjitale;
- ç) çdo urdhër apo vendim i kryetarit të gjykatës i nxjerrë në ushtrim të kompetencave të tij për organizimin e gjyqtarëve apo të administratës në gjykatë;
- d) të dhëna statistikore mbi funksionimin e gjykatës të krahasuara me pesë vitet e mëparshme;
- dh) raportet e inspektimit të gjykatës nga institucionet shtetërore;
- e) çdo dokument që tregon aftësitë komunikuese të kryetarit me publikun dhe të tretët;
- ë) mendimi i Dhomës Vendore të Avokatisë dhe i Prokurorisë pranë gjykatës, ku kryetari ushtron detyrën;
- f) informacion me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës apo institucione të tjera që tregon pjesëmarrjen dhe aktivizimin e kryetarit në aktivitetet trajnuese për drejtimin dhe organizimin e gjykatës;
- g) të dhënat mbi verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj tij në cilësinë e kryetarit të gjykatës gjatë periudhës së vlerësimit;
- gj) vendimin disiplinor përfundimtar të tij në cilësinë e kryetarit, të dhënë gjatë periudhës së vlerësimit;
- h) kundërshtimet e kryetarit dhe procesverbalet eventuale të seancave dëgjimore të tij gjatë procesit të vlerësimit;



i) çdo burim tjetër që tregon veprimtarinë profesionale të kryetarit të gjykatës.

#### Neni 18

### **Nivelet e vlerësimit**

1. Vlerësimi i veprimtarisë të kryetarit të gjykatës përbëhet nga tre nivelet e mëposhtme:
  - a) “Shumë Mirë” në rastin e veprimtarisë drejtuese të gjykatës me cilësi të lartë;
  - b) “Mirë” në rastin e veprimtarisë drejtuese të gjykatës me cilësi mesatare;
  - c) “I pamjaftueshëm” në rastin e veprimtarisë drejtuese të gjykatës me cilësi të ulët.
2. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë Mirë” jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit të gjykatës vlerësohet “Shumë Mirë” në të dyja kriteret. Vlerësimi i përgjithshëm “I pamjaftueshëm” jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit të gjykatës vlerësohet “I pamjaftueshëm” në të paktën një prej kriterëve. Në rastet e tjera, veprimtaria drejtuese e kryetarit të gjykatës vlerësohet “Mirë”.

### **KREU III**

## **PROCEDURA E VLERËSIMIT**

### **Seksioni I**

#### **Dispozita të përgjithshme**

#### Neni 19

### **Periudha e vlerësimit**

1. Çdo gjyqtar vlerësohet së paku një herë në 3 vjet, sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj;
2. Kryetari i gjykatës vlerësohet së paku një herë në 4 vjet, sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj. Në çdo rast veprimtaria e tij vlerësohet brenda kohëzgjatjes së mandatit, por jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i mandatit të tij.

### **Seksioni II**

#### **Fillimi i vlerësimit**

#### Neni 20

### **Programi i vlerësimit dhe njoftimi**

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti përcakton programin e vlerësimit të veprimtarisë së gjyqtarëve dhe të kryetarëve të gjykatave, që duhet të vlerësohen përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit. Programi përfshin ata gjyqtarë periudha e vlerësimit të cilëve përfundon në 16 muajt e ardhshëm sipas radhës së mbarimit të periudhës së vlerësimit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë njofton në kohën e duhur kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët, veprimtaria e të cilëve duhet të vlerësohen sipas programit të miratuar.

#### Neni 21

### **Vetëvlerësimi i gjyqtarit**

1. Gjyqtari brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit sipas nenit 20 të këtij ligji, bën vetëvlerësimin profesional dhe etik të punës së tij, nëpërmjet të cilit:

a) përshkruan veprimtarinë e tij dhe bën një vlerësim të përgjithshëm të kësaj veprimtarie dhe deklaron mbi veprimtarinë e tij në lidhje me kriterin e vlerësimit;

b) paraqet një analizë të të dhënave statistikore mbi veprimtarinë gjyqësore të tij;

c) tregon nevojat e tij për trajnim;

ç) përcakton objektivat për përmirësimin e tij profesional;

d) përshkruan hapat që ka ndërmarrë për përmbushjen e objektivave që ka përcaktuar në vlerësimin e mëparshëm;

dh) përshkruan masën në të cilën këto objektiva janë përmbushur duke dhënë edhe shpjegimin përkatës;

e) përshkruan rrethanat që e kanë penguar për ngritjen profesionale dhe formulon propozimet konkrete për zgjidhje.

2. Gjyqtari është i detyruar të dorëzojë vetëvlerësimin pranë kryetarit të gjykatës, ku ushtron detyrën, brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit sipas nenit 20 të këtij ligji.

3. Në çdo rast, vetëvlerësimi i gjyqtarit, duhet të shoqërohet me 4 vendime të përzgjedhura nga vetë gjyqtari, dokumente që tregojnë angazhimin në aktivitetet profesionale ndërinstitucionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës dhe çdo e dhënë tjetër që tregon veprimtarinë profesionale. Dëshmia për trajnimin jashtë Shkollës së Magjistraturës duhet të tregojë përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e aktivitetit, si dhe të dhëna mbi institucionin që ka organizuar aktivitetin.

#### Neni 22

### **Mendimi i kryetarit i gjykatës**

1. Kryetari i gjykatës ku ushtron veprimtarinë gjyqtari që vlerësohet jep një mendim mbi veprimtarinë e gjyqtarit.

2. Mendimi i kryetarit të gjykatës, përshkruan veprimtarinë e gjyqtarit, duke dhënë vlerësimin e tij, sipas niveleve të vlerësimit në raport me kriteret e vlerësimit të përcaktuara në këtë ligj, sidomos për ato kritere ku kryetari i gjykatës ka një vlerësim të ndryshëm nga vetëvlerësimi i gjyqtarit. Gjithashtu, mendimi i kryetarit të gjykatës përfshin një analizë të të dhënave statistikore të veprimtarisë së gjyqtarit.

3. Mendimi i kryetarit të gjykatës i njoftohet gjyqtarit brenda 4 javëve nga marrja e njoftimit sipas nenit 20 të këtij ligji.

4. Brenda 3 (tre) ditëve nga njoftimi i mendimit, gjyqtari, ka të drejtën të kërkojë të dëgjohet nga kryetari.

5. Gjyqtari dëgjohe nga kryetari i gjykatës brenda 2 javëve nga depozitimi i kërkesës. Kryetari i gjykatës dokumenton seancën dëgjimore me procesverbal, i cili i bashkëlidhet mendimit të kryetarit.

6. Jo më vonë se 2 muaj nga data e njoftimit sipas nenit 20 të këtij ligji, kryetari i gjykatës jep mendimin përfundimtar mbi veprimtarinë e gjyqtarit, që përfshin edhe vlerësimin e kundërshtimeve eventuale të gjyqtarit.

#### Neni 23

### **Dërgimi i akteve të vlerësimit nga kryetari i gjykatës**

1. Kryetari i gjykatës përcjell në Këshillin e Lartë të Drejtësisë aktet e vlerësimit të gjyqtarit brenda 2 muajve nga data e njoftimit sipas nenit 20 të këtij ligji.

2. Në aktet e vlerësimit përfshihen:

a) akti i vetëvlerësimit të gjyqtarit, 4 vendimet e përzgjedhura prej tij si dhe çdo të dhënë tjetër të paraqitur nga gjyqtari;

b) mendimi i kryetarit të gjykatës;

c) kundërshtimet eventuale të gjyqtarit mbi mendimin e kryetarit dhe procesverbalin e seancës dëgjimore.

### **Seksioni III**

### **Procesi i vlerësimit**

#### Neni 24

### **Roli i Inspektoratit**

1. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë përgatit dokumentacionin e nevojshëm për periudhën e vlerësimit.

2. Inspektorët janë përgjegjës përpara Kryeinspektorit dhe i përmbushin detyrat që kërkohen për vlerësimin nën drejtimin e Kryeinspektorit.

3. Kryeinspektori, me marrjen e akteve të vlerësimit të dërguara nga kryetari i gjykatës, cakton inspektorin përgjegjës për vlerësimin.

4. Gjyqtari njoftohet me shkrim për inspektorin përgjegjës për vlerësimin e tij.

#### Neni 25

### **Krijimi i dosjes së vlerësimit**

1. Inspektori përgjegjës krijon dosjen e vlerësimit, e cila përmban:

a) aktet e vlerësimit të paraqitura nga kryetari i gjykatës;

b) përmbledhje të të dhënave statistikore mbi:

i) numrin e çështjeve të gjykuara nga gjyqtari si kryesues, numrin e çështjeve të gjykuara si anëtar i trupit gjykues, numrin e çështjeve, ku gjyqtari është deleguar të gjykojë në një gjykatë tjetër. Këto të dhëna kategorizohen sipas natyrës së çështjeve;

ii) të dhëna lidhur me kohën e gjykimit të çështjeve në raport me standardet minimale kohore dhe numrin e çështjeve të gjykuara përtej standardeve minimale; numrin e seancave gjyqësore për çdo çështje; rendimentin e përfundimit të çështjeve të gjyqtarit dhe kohën e arsytimit të çdo vendimi;

iii) çdo të dhënë tjetër statistikore të përcaktuar me vendim nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

c) të dhënat mbi verifikimet të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës e vlerësimit, mbi inspektimin e veprimtarisë së gjyqtarit apo të gjykatës, si dhe vendimeve përfundimtare për dhënien e masave disiplinore ndaj gjyqtarit të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit .

ç) numrin e çështjeve, në të cilat gjyqtari është përjashtuar për shkak të konfliktit të interesit, me kërkesë të palëve.

2. Inspektori përfshin në dosje çdo akt që ai grumbullon në procedurën e vlerësimit sipas këtij ligji.

3. Gjyqtari ka të drejtën e aksesit në çdo kohë në dosjen e tij të vlerësimit dhe të marrjes së kopjes së akteve apo të ekstrakteve të tyre.

## Neni 26

### **Përzgjedhja e çështjeve për vlerësim**

1. Për vlerësimin e veprimtarisë së gjyqtarit përzgjidhen me short jo më shumë se 22 çështje gjyqësore gjithsej, të gjykuara nga gjyqtari në periudhën e vlerësimit. 16 dosje përzgjidhen për vlerësim të përgjithshëm, nga të cilat 8 dosje për çdo vit kalendarik të periudhës së vlerësimit. Pjesa tjetër e dosjeve përzgjidhen për zvarritje, nga të cilat 5 % por jo më shumë se 6 çështje gjithsej nga numri i përgjithshëm i çështjeve të gjykuara përtej afateve standarde.

2. Inspektori përgjegjës identifikon dhomën dhe seksionin ku gjyqtari ka ushtruar funksionin për periudhën e vlerësimit dhe, më pas, në varësi edhe të numrit të çështjeve të dhëna për çdo kategori çështjesh, përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen nga secila prej tyre në mënyrë proporcionale.

3. Në short përfshihen të gjitha çështjet e gjyqtarit, ku ai ka qenë kryesues, duke përfshirë edhe numrin e çështjeve, ku gjyqtari është deleguar të gjykojë në një gjykatë tjetër.

4. Numri i çështjeve të gjyqtarit, të përzgjedhura me anë të shortit, të përfunduara me vendim procedural, nuk duhet të kalojë 10 % të numrit total të çështjeve të përzgjedhura. Çështjet gjyqësore të këtij lloji të përzgjedhura, pas plotësimit të kësaj kuote, nuk konsiderohen dhe shorti vazhdon për përzgjedhjen e çështjeve të llojeve të tjera.

5. Numri i çështjeve gjyqësore pa palë kundërshtare të gjyqtarit, të përzgjedhura me anë të shortit, nuk duhet të kalojë 20% të numrit total të çështjeve të përzgjedhura. Çështjet gjyqësore të këtij lloji të përzgjedhura pas plotësimit të kësaj kuote nuk konsiderohen dhe shorti vazhdon për përzgjedhjen e çështjeve të kategorive të tjera.

6. Shorti i çështjeve gjyqësore kryhet pas fillimit të procedurës së vlerësimit të gjyqtarit dhe pavarësisht veprimeve të tjera pjesë përbërëse të këtij procesi.

7. Kryerja e shortit urdhërohet dhe mbikëqyret nga inspektori përgjegjës, duke zbatuar rregullat e këtij neni. Shorti realizohet në gjykatën ku ushtron funksionet gjyqtari dhe kryhet nga administrata gjyqësore e gjykatës. Shorti kryhet në prani të gjyqtarit, kur ai e çmon të marrë

pjesë. Shorti sipas kësaj dispozite dokumentohet në procesverbalin që nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit, i cili përfshihet në dosjen e vlerësimit.

8. Pas përzgjedhjes së çështjeve, inspektori i vlerëson ato pa vonesë në raport me kriterin vlerësues.

9. Kryetari dhe kancelari i gjykatës i krijojnë inspektorit mundësitë e duhura për ushtrimin e detyrës.

#### Neni 27

### **Të dhënat mbi trajnimet profesionale**

1. Inspektori përgjegjës grumbullon dhe përfshin në dosjen e vlerësimit të dhënat mbi aktivitetet profesionale dhe trajnuese të gjyqtarit.

2. Shkolla e Magjistraturës, si organi i vetëm përgjegjës për formimin vazhdues të gjyqtarëve, dokumenton pjesëmarrjen e gjyqtarit në aktivitetet profesionale dhe trajnuese. Shkolla e Magjistraturës kujdeset që, informacioni mbi pjesëmarrjen e gjyqtarit në aktivitetet profesionale dhe trajnuese përcillet brenda 2 javë nga dita e depozitimit të kërkesës. Informacioni duhet të përmbajë numrin e trajnimeve në të cilat gjyqtari është thirrur, temën e trajnimeve, kohën e zhvillimit të tyre, shkallën e pjesëmarrjes së gjyqtarit dhe nëse është e mundur edhe nivelin e aktivizimit.

#### Neni 28

### **Projekt-vlerësimi**

1. Inspektori përgjegjës, brenda 1 muaji nga marrja e akteve të vlerësimit nga kryetari i gjykatës, harton projekt-vlerësimin.

2. Të gjitha të dhënat statistikore analizohen në kontekstin e duhur për të shmangur konkluzionet e bazuara në situatat që nuk lidhen me përgjegjësitë e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore mbi rendimentin e përfundimit të çështjeve, kohëzgjatjen e gjykimeve dhe kohën e arsytimit të vendimeve bazohet, ndër të tjera, në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjes së papritur të volumit të çështjeve dhe çështjeve që lidhen me numrin e personelit dhe infrastrukturës së gjykatës.

3. Vetëvlerësimi dhe mendimi i kryetarit të gjykatës çmohen duke verifikuar saktësinë e tyre sipas informacionit të grumbulluar nga burimet e vlerësimit.

4. Në çdo rast vlerësimi i aftësive gjyqësore të përcaktuara në nenin 8 pika 4 e këtij ligji, duhet të shmangë ndërhyrjen në pavarësinë e gjyqtarëve.

5. Projekt-vlerësimi përmban:

a) të dhënat personale të gjyqtarit, arsimimi, vjetërsia si gjyqtar, nivelet e mëparshme të vlerësimit dhe informacion të përgjithshëm mbi periudhën e vlerësimit, dhoma apo seksioni ku ai ka ushtruar veprimtarinë dhe masat disiplinore të marra ndaj tij në periudhën e vlerësimit;

b) të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të grumbulluara dhe analiza e tyre për vlerësimin e veprimtarisë së gjyqtarit sipas kriterëve të vlerësimit;

- c) propozimin e nivelit të vlerësimit duke iu referuar çdo kriteri të vlerësimit dhe nivelit të përgjithshëm të vlerësimit;
- ç) Propozimet për trajnime, ose rekomandime për hapat që duhen ndërmarrë me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së gjyqtarit;
- 6. Projekt-vlerësimi shoqërohet nga një raport që përshkruan dhe analizon me detaje të dhënat e mbledhura nga inspektori;
- 7. Kryeinspektori rishikon projekt-vlerësimin kundrejt saktësisë faktike dhe përputhshmërinë me praktikën vlerësuese dhe e miraton atë duke e nënshkuar.
- 8. Projekt-vlerësimi përfshihet në dosjen e vlerësimit.

#### Neni 29

### **Të drejtat e gjyqtarit për të kundërshtuar projekt-vlerësimin**

1. Projekt-vlerësimi i njoftohet gjyqtarit, duke e vënë në dijeni edhe për të drejtën e aksesit në dosjen e vlerësimit.
2. Gjyqtari ka të drejtë të kundërshtojë me shkrim projekt-vlerësimin brenda 2 javëve nga marrja e njoftimit. Ai mund të paraqesë edhe prova të reja.
3. Gjyqtari mund të kërkojë të dëgjohet dhe të paraqesë prapësimet e tij gjatë seancës dëgjimore në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

#### Neni 30

### **Vendimi për vlerësimin**

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë fton gjyqtarin e interesuar, kryeinspektorin dhe sipas rastit edhe persona të tjerë në një seancë dëgjimore me kërkesë të gjyqtarit ose nëse kjo është e nevojshme për të sqaruar faktet.
2. Nëse gjatë marrjes së vendimit mbi vlerësimin pretendohen dhe verifikohen gabime materiale apo procedurale, ose të dhëna të tjera të nevojshme, të cilat mund të ndikojnë në nivelin e vlerësimit dhe që nuk mund të korrigjohen aty për aty për shkak të nevojës për mbledhjen e dokumenteve të tjera, Këshilli i Lartë i Drejtësisë urdhëron korrigjimin e tyre nga Inspektori dhe paraqitjen e projekt-vlerësimit në mbledhjen e radhës.
3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pas shqyrtimit të projektvlerësimit, vendos miratimin, miratimin me ndryshime ose shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm.
4. Në rast se Këshilli i Lartë i Drejtësisë vlerëson gjyqtarin në një nivel të ndryshëm ose bën një arsyetim të ndryshëm nga ai i propozuar në projektvlerësimin, atëherë ai, do të arsyetojë vendimin përkatës. Akti i vlerësimit siç është miratuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë është pjesë përbërëse e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
5. Kur veprimtaria e një gjyqtari ose e një kryetari vlerësohet “I pamjaftueshëm”, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, vendos inspektimin e gjyqtarit për efekt të evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve eventuale disiplinore të tij.
6. Këshilli i Lartë i Drejtësisë publikon ekstrakte të aktit të vlerësimit dhe të vendimit, të cilët pasqyrojnë të dhënat statistikore, analizën e të dhënave dhe nivelin e vlerësimit të arsyetuar.

Publikimi i ekstrakteve duhet të sigurojë mbrojtjen e konfidencialitetit dhe të dhënave personale. Në çdo rast, çdo informacion që mund të zbulojë identitetin e gjyqtarit duhet të hiqet nga ekstraktet.

7. Gjyqtari ka të drejtë të ankimojë vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për vlerësimin në Gjykatën e Lartë, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

8. Projekt-vlerësimi, vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe vendimet gjyqësore eventuale përfshihen në dosjen individuale të gjyqtarit.

#### Neni 31

### **Procedura e vlerësimit të kryetarit të gjykatës**

1. Procedura e vlerësimit e parashikuar nga ky ligj zbatohet edhe për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit të gjykatës, përveçse kur parashikohet ndryshe.

2. Kryetari i gjykatës e paraqet vetëvlerësimin dhe çdo burim të vlerësimit të tij në Këshillin e Lartë të Drejtësisë brenda tre javëve nga marrja e njoftimit, sipas nenit 20 të këtij ligji.

3. Në procedurën e vlerësimit të veprimtarisë së kryetarit të gjykatës nuk zbatohen pikat 2 dhe 3 të nenit 21, nenet 22 dhe 23, pika 1 e nenit 25 dhe neni 26.

#### Neni 32

### **Vlerësimi me kërkesë**

1. Në rastin e kërkesës për transferim ose ngritjes në detyrë të një gjyqtari, kur vlerësimi i fundit është realizuar për një periudhë përpara më shumë se 2 vjet, me kërkesën e gjyqtarit ndiqet procedura e përshpejtuar e vlerësimit. Procedura e vlerësimit të përshpejtuar për aq sa është e mundur, realizohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

2. Periudha e procedurës së përshpejtuar të vlerësimit është viti i fundit i plotë kalendarik. Programi i gjyqtarëve, veprimtaria e të cilëve duhet të vlerësohen sipas kësaj procedure përpara dhënies së vendimit për ngritjen në detyrë apo transferimin miratohet paraprakisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

3. Numri i çështjeve që përzgjidhen me short për vlerësim të përgjithshëm është 6; numri i vendimeve që mund të paraqiten nga vetë gjyqtari është 2, ndërsa numri maksimal i çështjeve të gjykuara tej afateve standarde është maksimumi 3 çështje.

4. Afati i përgatitjes së projekt-vlerësimit është 1 muaj nga dita e dorëzimit të akteve të vlerësimit nga kryetari i gjykatës.

5. Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për vlerësimin e gjyqtarëve në mbledhjen e radhës, pasi gjyqtarit i është njoftuar projekt-vlerësimi.

## **Seksioni IV**

### **Raportimi dhe transparenca**

#### Neni 33

### **Raporti vjetor**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë harton çdo vit kalendarik një përshkrim të raportit përmbledhës të vlerësimit të kryer në vitin e mëparshëm. Ky raport publikohet në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

Neni 34

### **Raporti periodik mbi Sistemin e Vlerësimit**

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë publikon çdo 3 vjet një raport periodik mbi sistemin e vlerësimit.
2. Raporti përmban të paktën:
  - a) një përshkrim të përgjithshëm të vlerësimeve të kryera përgjatë periudhës së raportimit;
  - b) një analizë të rezultateve me qëllim identifikimin e dobësive dhe përparësive të trupës gjyqësore dhe të sistemit gjyqësor;
  - c) një analizë të efikasitetit të rekomandimeve të miratuara në periudhën raportuese paraardhëse.
  - ç) rekomandimet që duhen ndërmarrë me qëllim tejkalimin e dobësive të identifikuar;
3. Raporti periodik publikohet jo më vonë se në fund të muajit mars të vitit që pason periudhën e raportuar.

## **KREU IV**

### **DISPOZITAT E FUNDIT DHE KALIMTARE**

Neni 35

#### **Dispozitë kalimtare**

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë përfundon vlerësimin e gjyqtarëve për periudhën 2007-2009 bazuar në rregullat ekzistuese përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në përfundim të procesit të vlerësimit të kësaj periudhe, brenda 3 muajve nga përfundimi i procesit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë publikon raportin sipas nenit 34 të këtij ligji.
2. Përjashtimisht nga parashikimi i nenit 19, Këshilli i Lartë i Drejtësisë brenda datës 30 shtator 2015 fillon vlerësimin profesional të gjyqtarëve për periudhën e vlerësimit 2010-2014 me objektivin e përfundimit të tij brenda vitit 2016. Për vlerësimin e kësaj periudhe zbatohen rregullat e këtij ligji.
3. Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Lartë i Drejtësisë miraton programin e gjyqtarëve, të cilët vlerësohen në cilësinë e kryetarit të gjykatës sipas këtij ligji.
4. Të dhënat statistikore përpunohen nga gjykata, ku gjyqtari që vlerësohet ushtron detyrën dhe përcillen nga kryetari i gjykatës, deri në kohën kur inspektorati të sigurojë drejtpërdrejt të dhëna statistikore të sakta dhe të sigurta në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykata. Koha e fillimit të marrjes së të dhënave statistikore drejtpërdrejt në sistem nga inspektorati përcaktohet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
5. Treguesit mbi numrin e seancave dëgjimore për çështje janë pjesë e vlerësimit profesional dhe etik pas vitit 2016. Deri në këtë periudhë vlerësimi, ky tregues evidentohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe zvarritje.



6. Rregulli i përcaktuar në nenin 21, pika 1 shkronja “dh” dhe “e” zbatohet vetëm për vlerësimin profesional dhe etik duke filluar me vitin 2015.

#### Neni 36

#### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Lartë i Drejtësisë që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet normative në zbatim të neneve 3 dhe 25 dhe 35 të këtij ligji.

#### Neni 37

#### **Shfuqizime dhe ndryshime**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen dhe/ose ndryshohen dispozitat e mëposhtme:

a) Në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar:

i) ku respektivisht gjendet togfjalëshi “vlerësim moral dhe profesional” zëvendësohen me togfjalëshin “vlerësim profesional dhe etik”;

ii) shkronja “dh” të nenit 2 ndryshohet si vijon: “kujdeset dhe garanton procesin e vlerësimit dhe vendos për vlerësimin e veprimtarisë së gjyqtarëve”;

iii) Në nenin 14 pika 6, togfjalëshi “ çdo dy vjet” zëvendësohet me togfjalëshin “çdo tre vjet”.

iv) shkronja “d” dhe “dh” të paragrafit 1 të nenit 16 shfuqizohen;

v) Në nenin 30, pika 1 shfuqizohet.

b) Në ligjin nr. 9877, datë 18.2.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

i) Në nenin 12 pika 4, shfuqizohet togfjalëshi “në përputhje me renditjen në listën e përhershme, sipas nenit 14 të këtij ligji”;

ii) neni 13 ndryshohet si vijon:

#### “Neni 13

#### Vlerësimi profesional dhe etik i gjyqtarit

Vlerësimi profesional dhe etik i gjyqtarit kryhet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me ligj të veçantë.”

iii) neni 14 shfuqizohet.

#### Neni 38

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.